



GJYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
COUR EUROPEENNE DES DROITS DE L'HOMME

Deklaratë për shtyp lëshuar nga  
Regjistruesi i Gjykatës

ECHR 161 (2011) 27.09.2011

I justifikuar mostrajtimi me prioritet i një kërkesë strehimi social nga një  
emigrant, i biri i të cilit ishte i lejuar me kusht të qëndronte në Mbretërinë e  
Bashkuar.

Në vendimin e sotëm të Dhomës në çështjen [Bah kundër Mbretërisë së Bashkuar](#) (ankimi nr. 56328/07), i cili nuk është i formës së prerë<sup>1</sup>, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi unanimisht se ka patur:

Asnjë shkelje e Nenit 14 (ndalim i diskriminimit) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, marrë në lidhje me Nenin 8 (mbrojtja e të drejtës për jetë private dhe familjare).

Çështja kishte të bënte me një ankesë rreth një vendimi të autoritetit lokal lidhur me refuzimin e një vendosjeje prioritare në listën për banim social të një nëne dhe djalit të saj të mitur, të dy shtetas të Sierra Leone.

### Fakte kryesore

Ankuesi, Husenatu Bah, një shtetas i Sierra Leone-s me banim në Londër (Mbretëria e Bashkuar).

Pas pretendimit pa sukses për azil në Mbretërinë e Bashkuar, menjëherë pas mbërritjes së saj atje në vitin 2000, në vitin 2005 asaj iu dha e drejta e lejeqëndrimit pa afat për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar. Djali i saj, i lindur në vitin 1994, u bashkua me të në Londër në vitin 2007. Ai u lejua të hyjë dhe të qëndrojë në Mbretërinë e Bashkuar me kusht që ai të mos përfitonte nga burime të fondeve publike.

Menjëherë pasi djali i saj mbërriti, znj Bah iu kërkua të largohej nga dhoma që ajo kishte marrë me qera, duke qenë se pronari i saj nuk ishte i gatshëm të akomodonte djalin e saj. Znj. Bah aplikoi në London Borough të Southwark për trajtimin me prioritet në marrjen e strehimit social. Individët të cilët pa dashje humbasin shtëpitë e tyre dhe kanë fëmijë të mitur trajtohen zakonisht me përparësi nga autoritetet lokale kur vendoset mbi sigurime të strehimit social. Megjithatë, për shkak se djalit të Znj. Bah i ishte dhënë vetëm leja për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar me kusht që të mos kishte rekurs në fondet publike, ai nuk mund të merrej parasysht në vlerësimin nëse ajo kishte nevojë prioritare për ndihmë strehimi.

<sup>1</sup> Sipas Neneve 43 dhe 44 të Konventës, ky gjykim i Dhomës nuk është i formës së prerë. Gjatë periudhës tre mujore pas dhënies së tij, çdo palë mund të kërkojë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe të Gjykatës. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, një trup prej pesë gjyqtarësh shqyrton nëse çështja meriton shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë rast, Dhoma e Madhe do të dëgjojë rastin dhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë në atë ditë.

Pasi një aktgjykim bëhet i formës së prerë, ai i transmetohet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të tij. Informacione të mëtejshme në lidhje me procesin e ekzekutimit mund të gjeni këtu: [www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution)

Autoritetet lokale e ndihmuan Znj. Bah të gjente strehim në sektorin privat jashtë qytetit dhe ajo dhe djali i saj nuk ishin fare të pastrehë. Megjithatë, ajo duhet të paguante një qira më të lartë se ajo që do ti duhej të paguante nëse do të përfitonte nga strehimi social, si dhe djali i saj duhej të udhëtonte rreth katër orë çdo ditë, duke qenë se shkolla e tij ishte shumë larg nga ku ata do të jetonin. 17 muaj më vonë, Znj. Bah iu ofrua një apartament nga këshilli me një dhomë gjumi Southëark, të cilin ajo e pranoi.

## Ankimimet, procedura dhe përbërja e Gjykatës

Duke u bazuar në Nenin 14 në lidhje me Nenin 8, Znj. Bah u ankua se ajo ishte diskriminuar duke mos u trajtuar me përparësi për strehim social.

Kërkesa u parashtrua në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut më 23 nëntor 2007.

Gjykimi u dha nga një Dhomë prej shtatë anëtarësh, e përbërë si vijon:

Lech Garlicki (Poloni), **Kryetar**,  
Nicolas Bratza (Mbretëri e Bashkuar),  
Ljiljana Mijovic (Bosnjë dhe Hercegovinë),  
Sverre Erik Jebens (Norvegji),  
Paivi Hirvela (Finlandë),  
Ledi Bianku (Shqipëri),  
Vincent A. de Gaetano (Maltë), **Gjyqtarë**,  
Dhe gjithashtu Fatoş Araci, **Zëvendës Regjistruer i Seksionit**.

## Vendimi i Gjykatës

### Nenet 8 dhe 14

Gjykata rikujtoi se nuk ekziston asnjë e drejtë sipas nenit 8 të Konventës në lidhje me pajisjen me strehim social. Megjithatë, kur një Shtet vendos të sigurojë një përfitim të tillë, ai duhet ta bëjë këtë në një mënyrë jo diskriminuese.

Djali i Znj. Bah ishte lejuar të hynte dhe të qëndronte në Mbretërinë e Bashkuar me kushtin e qartë që nuk do të mund të përdorte fondet publike. Ishte, pra, për shkak të statusit të tij të imigracionit me kusht dhe jo për shkak se ai ishte një shtetas i Sierra Leone, që nënës së tij i ishte mohuar trajtimi me prioritet sipas legjislacionit të strehimit.

Duke pasur parasysh mungesën e strehimit social, për autoritetet kombëtare ishte e ligjshme vënia në vend e kriterëve për ndarjen e saj, për sa kohë që kriteret nuk ishin arbitrare ose diskriminuese.

Legjislacioni përcaktonte qartë se cilat kategori të njerëzve përfitonin banim social, duke përfshirë edhe ata që duhej të konsideroheshin me prioritet. Kështu, njerëzit me të drejtë të caktuar qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar, refugjatët dhe ata të lejuar të qëndrojnë pa kushte përfitonin të drejtën për strehim dhe për ndihmë strehimi. Ata, e drejta e të cilëve për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar ishte e kushtëzuar, nuk e përfitonin këtë të drejtë.

Nuk kishte asgjë arbitrare në mohimin e prioritetit ndaj Znj. Bah. Duke qenë se ajo e kishte sjellë djalin e saj në Mbretërinë e Bashkuar plotësisht e vetëdijshme për gjendjen që do ti bashkangjitej pranisë së tij atje, ajo e kishte pranuar në mënyrë efektive atë kusht dhe si pasojë kishte pranuar të mos bënte rekurs për fonde publike për të mbështetur djalin e saj.

Pa nënçmuar ankthin të cilin ajo duhet të ketë vuajtur si rezultat i kërcënimit për të qenë e pastrehë, Gjykata vuri re se ajo kurrë nuk kishte qenë në të vërtetë e pastrehë. Apartamenti i përfituar prej saj ishte i siguruar me ndihmë të autoriteteve lokale. Përveç kësaj, edhe njerëzit të cilët do të ishin trajtuar me prioritet do të duhet - në të gjitha gjasat – të përfitonin strehim social përfaqësisht në të njëjtën kohë me të.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektive e kishte arsyetuar refuzimin e tyre për të trajtuar Znj. Bah me prioritet gjatë ofrimit të ndihmës për strehim social. Për këtë arsye nuk kishte pasur shkelje të Nenit 14 të marrë në lidhje me Nenin 8.

*Gjykimi është i disponueshëm vetëm në gjuhën angleze.*

Kjo deklaratë për shtyp është një dokument i prodhuar nga Zyra e Regjistrimit. Ajo nuk është detyruese për Gjykatën

Vendimet, gjykimet dhe informacione të tjera rreth Gjykatës mund të gjenden në [ëëë.echr.coe.int](http://ëëë.echr.coe.int). Për të marrë deklaratat për shtyp të Gjykatës, ju lutem abonohuni në Court's RSS feeds.

### **Personat e Kontaktit të Shtypit**

[echrpress@echr.coe.int](mailto:echrpress@echr.coe.int) | tel: +33 3 90 21 42 08

**Kristina Pencheva-Malinowski (tel: + 33 3 88 41 35 70)**

Emma Hellyer (tel: + 33 3 90 21 42 15)

Tracey Turner-Tretz (tel: + 33 3 88 41 35 30)

Nina Salomon (tel: + 33 3 90 21 49 79)

Denis Lambert (tel: + 33 3 90 21 41 09)

**Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut** u krijua në Strasburg nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës në vitin 1959 për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950.